



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 9, datë 28.01.2022

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR.14, RRUGA “PETRAQ BOSHNJAKU”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.22, datë 25.02.2021 “Për miratimin e listës të subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit për Pallatin nr.1062, rruga “26 Nëntori” dhe Pallatin nr.14, rruga “Petraq Boshnjaku”, Njësia Administrative nr.2, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të zëvendëskryetares së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e proçesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr.1 “Pallati nr.1062, rruga “26 Nëntori”, Zona Kadastrale 8512”, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.22, datë 25.02.2021 “Për miratimin e listës të subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit për Pallatin nr.1062, rruga “26 Nëntori” dhe Pallatin nr.14, rruga “Petraq Boshnjaku”, Njësia Administrative nr.2, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
2. Miratimin e ndryshimit në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 25.02.2021 përsa i përket ndryshimit të strukturës të përfitur nga z. Hamdi Kryeziu, znj.Burbuqe Kryeziu, nr.rendor 21, si subjekt përfitues nga programi i proçesit të rindërtimit në masën 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e proçesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 31.01.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 92/4 prot.



Durrës, më 07.02.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.9 datë 28.01.2022: "Për miratimin e ndryshimit të aneksit nr.1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.22, datë 25.02.2021 "Për miratimin e listës të subjekteve përfituese që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.1062, rruga "26 nëntori" dhe pallatin nr.14, rruga "Petraq Boshnjaku", Njësia Administrative Nr.2, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019"

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO